



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 08.06.2016

Ref.: 412/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 42-të, të mbajtur më 31 maj 2016, mori:

## V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr.266/16, datë: 19.05.2016 e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.237/16, datë 22.04.2016.

## Arsy etimi

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) me datë 19.05.2016 ka pranuar kërkesë nga Universiteti “Isa Boletini” për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.237/16, datë: 22.04.2016. Universiteti “Isa Boletini” përmes kërkesës për rishqyrtim të vendimit të parashtruar me 19.05.2016 ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i KSHC-së i datës 22.04.2016, nr. 237/16 dhe të aprovohet aplikacioni për akreditim të programeve të studimit: Makineri Prodhuese PhD dhe Inxhinieri Ekonomike MSc.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Universitetit “Isa Boletini” dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 19.05.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 22.04.2016.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën (nr.266/16, datë: 19.05.2016) e Universitetit “Isa Boletini” për rishqyrtim të vendimit, dhe ka konstatuar se Universiteti i Mitrovicës nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do ta argumentonte plotësimin e kriterëve që parashihen për një program të studimit sipas nenit 11, pika 3.2 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA) nr. 02/2013, datë 16.01.2013. Si rezultat i mos përmbushjes së kriterëve që parashihen në Udhëzimin Administrativ për Akreditim, KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës së Universitetit “Isa Boletini”.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"
- Arkivit të AKA-së.
- MASHT

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë